



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2019:185740

Datë: 30.05.2024

Numri i dokumentit: 05760195

KE.nr.462/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Alajdin Tërshnjaku, duke vendosur lidhur me ligjshmërinë e marrëveshjes së lidhur më 24.02.2024, në Zyrën e Ndërmjetësimit të Gjykatës Komerciale në mes paditësit NPPSH "Termo Klima", me seli në Mitrovicë me pronar S.O. me numër ID..., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokat Naim Spahiu, me seli të zyrës në Prishtinë dhe të paditurit NP "Bahçe", me seli në Mitrovicë me pronar S.G. me nr.ID ..., e të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokati Uvejs Gashi me seli të zyrës në Mitrovicë, lidhur me procedurën e ndërmjetësimit, bazuar në nenin 8 dhe 9 dhe nenit 12, paragrafi 12.5 të Ligjit për Ndërmjetësim, më 29.05.2024 jashtë seance mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET Marrëveshja e Ndërmjetësimit, më numër Nd.nr.24/2024 e datë 24.02.2024 e lidhur në Zyrën për Ndërmjetësim pranë Gjykatës Komerciale, në mes të paditësit NPPSH "Termo Klima", me seli në Mitrovicë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokat Naim Spahiu, me seli të zyrës në Prishtinë dhe të paditurit NP "Bahçe" me seli në Mitrovicë e të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokati Uvejs Gashi, me seli të zyrës në Mitrovicë, në çështjen kontestimore kompensim i borxhit.

A r s y e t i m i

Në Gjykatën Komerciale – Departamenti Ekonomik, është duke u zhvilluar procedura kontestimore me objekt kontesti kompensim i borxhit e evidentuar në gjykatë si KE.Nr.462/23 nga paditësi NPPSH "Termo Klima", me seli në Mitrovicë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokati Naim Spahiu me seli të zyrës në Prishtinë dhe të paditurit NP "Bahçe" me

seli në Mitrovicë e të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokati Uvejs Gashi, me seli të zyrës në Mitrovicë.

Pranë kësaj Gjykate, respektivisht në seancën përgatitore të mbajtur me datë 14.02.2024, palët ndërgjyqëse i propozuan Gjykatës që rasti të referohet në procedurën e ndërmjetësimit, prandaj Gjykata konform nenit 8 paragrafi 1 të Ligjit për Ndërmjetësim këtë rast me propozimin e palëve e referoj në Zyrën e Ndërmjetësimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës.

Zyra për Ndërmjetësim pranë Gjykatës Komerciale, më 03.05.2024 e ka njoftuar gjykatën së palët në rastin konkret kanë arritur marrëveshje e ndërmjetësimit me numër Nd.nr.24/2024 të datës 24.02.2024 pranë kësaj Zyre, dhe nënshkrimi i marrëveshjes nga palët në procedurë është bërë më të njëjtën datë dhe gjykatës ia kanë dorëzuar marrëveshjen e lidhur në mes të palëve ndërgjyqësve.

Gjykata me rastin e shqyrtimit të marrëveshjes e cila është arritur me ndërmjetësim ka konstatuar se e njëjta nuk është e lidhur me kundërshtim me ligjin, në rastin konkret kemi të bëjmë me kërkesa për të cilat palët mund të disponojnë lirisht, në të cilën vullneti i palëve në këtë procedurë nuk është në konflikt dhe nuk janë cenuar të drejtat dhe interesat të tyre.

Andaj, Gjykata duke ju referuar të lartshënuarave dhe mbështetur në dispozitat e nenit 3 paragrafi 3, 411 dhe 412 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), neni 15 paragrafi 1 të Ligjit për Ndërmjetësimin me numër 06/L – 009, lidhur me nenin 17 paragrafi 1, të Rregullores Nr.04/2019 Për Procedurën e Ndërmjetësimit të Lëndëve të Gjykata, e nxjerr nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK), erdhi në përfundim së marrëveshja e ndërmjetësimit duhet të aprovohet, dhe e njëjta e ka fuqinë e titullit e përmbarues, konform Ligjit të Procedurës Përmbarimore.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Departamenti Ekonomik

KE.nr.462/23, datë 29.05.2024

Gjyqtari,

Alajdin Tërshnjaku

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.